

PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE



Ministrja Denaj zhvilloi një takim të nivelit të lartë me përfaqësues të Misionit vlerësues të Komisionit Evropian për Programin e Reformave Ekonomike 2020-2022. Diskutimet u fokusuan në përfundimet e bisedimeve dypalëshe me ministrinë e linjës dhe mbi rekomandimet e reja për Shqipërinë, veçanërisht në fushat e financave publike, arsimit profesional, zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, energjisë, shëndetësisë etj. Ministrja Denaj shprehu besimin se progresi i bërë drejt Reformave Ekonomike dhe angazhimi i mëtijshëm i Qeverisë Shqiptare japin siguri për hapjen e negociatave dhe përbushjen e rekomandimeve teknike të përcjella nga Komisioni Evropian. Drejtuesja e Misionit të KE, znj. Myriam Ferran tha se ERP duhet të harmonizohet edhe me prioritetet e fondeve IPA 3, që janë në mbështetje të procesit të integritetit. Znj. Denaj dhe znj. Ferran vlerësuan pozitivisht progresin e realizuar deri tani dhe synimet e përcaktuara për vitet e ardhshme.



Ministria e Financave dhe Ekonomisë nënshkroi me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim Marrëveshjen për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri. Marrëveshja u firmos nga Ministrja Denaj dhe drejtori i BERZH-it për Shqipërinë, z. Colangeli, ndërsa do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Programi parashikon dhënie të një shume prej 50 milionë dollarëve, në formën e huasë, për përmirësimin e infrastrukturës në tri akse rrugore lokale në vendin tonë që prekin zonën Vlorë-Orikum; Shëngjin-Velipojë dhe Librazhd-Bulqizë. Ministrja Denaj vlerësoi marrëveshjen e firmosur me BERZH dhe tha se qeveria shqiptare është e angazhuar në përbushjen e prioritetit të saj për të rritur aksesin drejt zonave rurale, jo vetëm nga qytetarët e turistët, por edhe nga investitorët e huaj, duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik të tyre dhe në rritjen e punësimit.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Gjon Bardhi, mori pjesë në forumin e biznesit të organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, ku u diskutuan çështje si: problematika të zbatimit të procedurave doganore, procedurat e vlerësimit ankimimit të vendimeve pranë autoriteteve doganore, çmimet e referencës dhe procedurat doganore, etj. Kreu i Doganave, prezantoi arritjet e 2019, por edhe objektivat për 2020, në përmirësim jo vetëm të punës së administratës që ai drejton, por edhe për lehtësimin e procedurave për sipërmarrjen. Sipas tij, gjatë vitit 2019 është dyfishuar numri i operatorëve ekonomikë që janë përfshirë në kanalin jeshil, është katërfishuar numri i operatorëve ekonomikë që janë përfshirë në kanalin blu, çka do të thotë shkurtim i kohës së përpunimit të deklaratave doganore dhe i kohës së qëndrimit të mallrave në doganë.



Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka realizuar shkatërrimin e 13 mijë lodrave të rrezikshme për fëmijët, në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit. Këto lodra u bllokuan nga ISHMT, me destinacion përfundimtar shkatërrimin e tyre, pas inspektiveve të kryera në subjektet e importit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë të produkteve lodra, gjatë periudhës nëntor 2019- janar 2020. Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut u bën thirrje të gjithë subjekteve që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit të produkteve lodra, që të zbatojnë legjislacionin, i cili është tërësisht i transpozuar dhe në përputhje me standardet europiane për prodhimin, importin dhe tregtimin e produkteve lodra.



Një delegacion nga Agjencia e Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit të Maqedonisë së Veriut u prit në një takim nga drejtori ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, z. Sokol Nano. Në këtë takim, përfaqësuesit prezantuan fokusin dhe misionin e institucioneve respektive, duke u ndalur në strategjinë për tërheqjen e investimeve të huaja dhe reformat qeveritare që e mbështesin këtë. Po ashtu, u diskutua edhe organizimi i një Study Tour në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të shkëmbyer përvojat dhe eksperiencat në tërheqjen e investimeve të huaja dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve vendase për dy vendet, por edhe në të mirën e rritjes ekonomike në rajon.



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka ushtruar rreth 946 kontrolle gjatë periudhës 31 janar-12 shkurt 2020. Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar 251 shkelje të legjislacionit tatimor, nga të cilat: 13 subjekte të pajegjistruara; 30 tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë), ndërsa 5 tatimpagues u janë bllokua ambientet për 30 ditë kalendrike për moslëshim kuponit tatimor (hera e dytë); 36 tatimpagues me punonjës të padeklaruar, nga të cilët 24 subjekte "biznes i vogël" dhe 12 subjekte "biznes i madh"; 6 tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe 1 tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune; 54 tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor.



447 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë periudhës 7-13 shkurt 2020. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 212 persona, i ndjekur nga qarku i Durrësit me 46 persona, qarku i Fierit me 42 persona, qarku i Elbasanit me 33 persona, etj.

MFE NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN ME BERZH

LEHTËSIMI I PROCEDURAVE PËR SIPËRMARRJEN

MBROJTJA E KONSUMATORIT

TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA

PLANI OPERACIONAL I ADMINISTRATËS TATIMORE

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS